



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:076656
Datë: 23.10.2024
Numri i dokumentit: 06338306

Ac.nr.7095/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti-kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve H., V., V., A. dhe V.N., që të gjithë nga fshati B., Komuna Ferizaj, të cilën me autorizim i përfaqëson F.Sh., kundër të paditurve Komuna Ferizaj, të cilën e përfaqëson me autorizim S.V. dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit të Tregut KOST me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim M.B. në çështjen juridike për kompensim, duke vendosur sipas ankesës të paditurës së dytë KOST, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.673/2017 të datës 06.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohen të pathemelta ankesa e paditësve H., V., V., A. dhe V.N., që të gjithë nga fshati B., Komuna Ferizaj dhe ankesa e të paditurës Operatori i Sistemit të Transmisionit të Tregut KOST me seli në Prishtinë, ashtu që pikat I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.673/2017 të datës 06.04.2021, vërtetohen.

II.Pika IV dhe V, të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 673/2017 i datës 06.04.2021, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.673/2017 të datës 06.04.2021, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve H., V., V., A. dhe V. të gjithë me mbiemër N. nga fshati B. Komuna Ferizaj, si e bazuar. Në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Operatori i Sistemit të Transmisionit të Tregut KOST Prishtinë, në emër të vlerës së humbur në shkallë prej 65% të pjesës së paluajtshmërive të

NK.nr... ZK..., në sipërfaqe prej 635m² e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 1.099m² t'ia shpërblej dëmin në shumë prej 28,892.50€, si dhe të pjesës së paluajtshmërisë të NK.nr... ZK ... në sipërfaqe prej 70m² e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 1.094m² t'ia shpërblej dëmin në shumë prej 3,185.00€, apo shumën e përgjithshme prej 32,077.50€ mbi të cilën janë të shtriravendosura linja-telat e energjisë elektrike 110KW tua shpërblej dëmin paditësve secilit veç e veç nga 6,415.50€ me kamat ligjore prej 8 %, nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 5.310€, të gjitha brenda afatit prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit. Në pikën III të dispozitivit e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve H., V., V., A. dhe V. të gjithë me mbiemër N. nga fshati B. Komuna Ferizaj përtej shumës së aprovuar sikurse në pikën II të dispozitivit apo shumën prej 47,210.50€ si e pa bazuar. Në pikën IV të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësve H., V., V., A. dhe V. të gjithë me mbiemër N. nga fshati B. Komuna Ferizaj, e paraqitur ndaj të paditurës së parë Komuna Ferizaj si e pa bazuar. Në pikën V të dispozitivit janë detyruar paditësit që solidarisht të paguajnë diferencën e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 85€.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i paditësit, pa cekur një për një shkaqet e ankimit të parapara me dispozitën e nenit 181 të LPK-së, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratoj ankesën e paditësve, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar në pjesën që është refuzuar kërkesëpadia e paditësve në atë mënyrë që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa e paditësve. Po ashtu ankesë në afatin ligjor ka ushtruar e paditura e dytë KOST në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që gjykata ankimore, të aprovoj si të themeltë ankesën e të paditurës dhe të prish aktgjykimin e ankimuar, dhe lënda të kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim në shkallë të parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa e palës paditëse dhe ankesa e të paditurës KOST janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se fillimisht paditësi tani i ndjeri F.N., pranë gjykatës së shkallës së parë kishte ushtruar padi për kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar, kundër të paditurës Komuna Ferizaj. Pasi që gjykata ka ndërprerë procedurën për shkak të vdekjes së paditësit F.N. ish nga Ferizaji, përfaqësuesi i autorizuar i paditësve me parashtresën e datës 12.10.2017, propozon vazhdimin e procedurës me trashëgimtarët sipas dëshmi vdekjes-tani paditësit, kundër të paditurës Komuna Ferizaj dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit të Tregut KOST me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi për shkak të shpronësimit sipas Vendimit me numër 03-nr.465-21 dt.11.08.2010, të cilin e ka marrë e paditura e parë Komuna Ferizaj me të cilin e ka bërë shpronësimin e ng.kad.nr... ZK..., pronë e paditësve, me qëllim të ndërtimit të linjës 110kv, që lidhet me TS 400/100Kv, në fshatin B., për nevojat e të paditurës së dytë.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësve pas administrimit dhe

shqyrtimit të provave: vendimi preliminar nr. 465-21 dt. 11.08.2010, kërkesa e KOST nr. 383 date 17.06.2010 për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ndërtimin e linjës 400 KV dhe linjës 110 KV, konkluzioni nr. 463 date 23.08.2010, aktvendimi i datës 09.08.2017 në të cilën është ndërpre procedura dëshmi vdekja e datës 11.10.2017 në emër të F.S.N., vendimi nr. 465-21 date 28.06.2010 në të cilën është miratuar kërkesa për shpronësim, vendimi nr. 68 dt. 30.06.2010 për shpalljen e interesit të përgjithshëm, fleta poseduese për NK 635/2 date 22.12.2017, mendimi i ekspertit të elektros Y.Z. janar 2018, mendimi i ekspertit vlerësues A.Ç. dt. 22.12.2017, plotësimi i ekspertit vlerësues A.Ç. dt. 15.02.2019, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerise LRP.nr.1675/17 dt. 09.06.2017, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerise LRP.nr.1933/16 dt. 20.06.2016, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerise LRP.nr.3301/15 dt. 11.09.2015, kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmerise LRP.nr.6377/2016 dt. 30.09.2016, procesverbali i dt. 20.12.2018 në të cilën është dëgjuar eksperti i gjeodezisë F.B. dhe ai i elektros Y.Z., plotësim ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F.B., fleta poseduese e datës 08.06.2018 për NK 635-2 dhe 635-5 në emër të paditëses H.N., aktvendimi nr. protokolli 54731/18 date 29.05.2014 në të cilën është lejuar regjistrimi i NK ... dhe ... në emër të paditëses H.N., procesverbali i dt. 29.01.2019 në të cilën është ri dëgjuar eksperti i gjeodezisë F.B. dhe ai vlerësues A.Ç., procesverbali i dt. 07.03.2019 në të cilën është ri dëgjuar ekspertit vlerësues A.Ç., ekspertiza e ekspertit vlerësues H.M. dt. 22.05.2019, plotësim ekspertiza e ekspertit vlerësues H.M. dt. 10.10.2019, super ekspertiza e dt. 28.02.2020 dhe procesverbalet e dt. 02.10.2019 dhe dt.13.11.2019 në të cilat është dëgjuar eksperti vlerësues H.M.. Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të ekzistimit të bazës së kërkesëpadisë ka vendosur lidhur me aprovimin e pjesëshëm të së njëjtës duke u bazuar në dispozitat e nenit 18, 86 par.3, 4, 5 dhe nenit 252 par.3 lidhur me par.2 të Ligjit për Pronën dhe të Drejtat Sendore, nenet 136, 140 dhe 382.2 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 452.1 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktvendimi nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqës për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve tjera nga neni 182.2 të LPK-së, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par.4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhmëni me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu

edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për bazën juridike të kërkesëpadisë dhe shumën e aprovuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ku me rastin e aprovimit të pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësve, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen çështjes e cila është objekt i këtij kontesti në rastin konkret. Me dispozitën 136, paragrafi 1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa bazën e kërkesëpadisë së paditësve gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F.B. e dt.23.12.2017 si dhe plotësimet e tjera të bëra me shkrim dhe në seanca gjyqësore, nga ka rezultuar se në kohën kur janë vendosur shtyllat për linjën 110kv, ka qenë një ngastër e vetme e cila ka qenë evidentuar ng.kad.nr..., në emër të F.N., mirëpo më pastaj është bërë copëtimi i saj, ashtu që tani rezulton se ng.kad.nr... dhe ..., ZK ..., sipas fletës poseduese dt.08.06.2018, evidentohen në emër të paditëses H.N. si pronare. Po ashtu në procedurën e të provuarit gjykata bazën e kërkesë padisë për kompensimin e dëmit e ka bazuar edhe në Rregulloren mbi përcaktimin e zonës nën servitut për linjat transmetuese 110, 220 dhe 400KV, numër 726 dt.03.11.2014, e nxjerr nga e paditura e dytë, ndërsa bazuar në mendimin e ekspertit elektros, se sa është sipërfaqja e dy paluajtshmërive ku nuk lejohet ndërtimi nën përçues elektrik dhe afër tij dhe sa ka humbur vlera e pronave në pronësi të paditësve duke u bazuar në këtë rregullore, këtë e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të elektros Y.Z., i cili në ekspertizën e janarit të vitit 2018, e plotësuar me dt.20.12.2018, ka rezultuar se nga skaji i linjës, ndërtimi nuk lejohet në gjerësi më afër se prej 5m, e që në kuadër të ng.kad.nr... nuk lejohet ndërtimi në sipër prej 635m² kurse në ng.kad.nr... sipërfaqja prej 70m² dhe në gjerësi 18m respektivisht 36m nga qendra e linjës, por jo më pak se 31m, që i referohet pjesës së servitutit respektivisht fitimit të drejtës për qasjes dhe kalimit në këto pjesë të pronave të paditësve. Nga ka rrjedh se e paditura e dytë me rastin e investimit që ka bërë në rrjetin energjetik 110kv e ka bërë shpronësimin e paluajtshmërive vetëm në pronat (pjesët e saj) ku janë të vendosura shtyllat, ndërsa në pronat tani kontestuese nuk kanë qenë të vendosura shtyllat por mbi të cilat janë të vendosura telat e përçuesit elektrik(linja 110kv) e cila nuk ka qenë kontestuese pasi që është vërtetuar përmes provave në shkresat e lëndës dhe daljes së gjykatës në vend shikim, por ka rezultuar se paditësit nuk janë kompensuar në mënyrë periodike apo të menjëhershme për vlerën e humbur për pjesët e pronës së tyre mbi të cilat është krijuar servituti respektivisht e drejta e qasjes dhe kalimit në këto prona për nevojat e ndërtimit, riparimit dhe mirëmbajtjes së linjës transmetuese, me të cilin veprim u ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm paditësve.

Për të vlerësuar pronat, gjykata në procedurë e të provuarit ka bërë marrjen e provës me ekspertizë duke e caktuar ekspertin vlerësues për të caktuar lartësinë e dëmit material që i është shkaktuar paditësve në pronat e tyre me rastin e instalimit të linjës 110KV, nëpër pronat e të cilëve kalojnë telat përçuesit të kësaj linje. Ekspertiza është punuar nga eksperti A.Ç., ekspert i licencuar, për identifikimin dhe vlerësimin e paluajtshmërisë, i cili ka bërë identifikimin e

paluajtshmërive në fjalë, përcaktimin e vendit të paluajtshmërive me ç'rast edhe ka bërë vlerësimin e paluajtshmërive të evidentuar në sipërfaqe të tërësishme prej 635m², dhe atë 70 € për 1 m², rezulton se për pjesën e vlerës së humbur pronari duhet të kompenzohet për 45.50€, për 1m² e duke shumëzuar me sipër prej 635m², për ng.kad..nr... i bije shuma prej 28,892.50€, kurse për ng.kad..nr..., që ka sipërfaqe prej 70m² duke shumëzuar me shumën prej 45.50€ për 1 m² rezulton shuma që duhet ti kompensohet në lartësi prej 3,185€ apo shuma e përgjithshme për këto dy prona që duhet t'iu kompensohet paditësve është në lartësi prej 32,077.50€, në emër të vlerës së humbur prej 65%.

Ekspertiza e ekspertit vlerësues A.Ç., është kundërshtuar nga e paditura KOST ndërsa gjykata sipas propozimit të saj ka bërë nxjerrjen e provës me anë të ekspertizës së re të përpiluar nga eksperti H.M. e datës 22.05.2019, por që kjo ekspertizë është kundërshtuar nga palët paditëse për çka është caktuar Grupi i ekspertëve në përbërje prej V.I. kryetar, M.M. dhe A.S., anëtarë të cilët kanë dhënë mendimin e tyre të dhënë me shkrim të datës 28.02.2020, dhe sqarimet në seancën e datës 23.03.2021. Gjykata me rastin e vendosjes për lartësinë e dëmit të shkaktuar në arsyetim të aktgjykimit i ka elaboruar të tri ekspertizat e nxjerra, mirëpo ka ardhur në përfundim se çmimi më real është dhënë nga eksperti vlerësues A.Ç. të cilës edhe ia ka falur besimin me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit, duke e vlerësuar si profesionale dhe objektive, pasi që eksperti është bazuar në kontratat e shitblerjes të cilat i ka marr për bazë kur e ka vlerësuar lartësinë e dëmit. Lidhur me besueshmërinë e ekspertizës të punuar nga eksperti vlerësues A.Ç., gjykata në këtë rast ka vepruar drejtë sepse është bindur nga konstatimet e ekspertit duke e pranuar të njëjtën në tërësi si të besueshme dhe bazë për të përcaktuar saktë lartësinë e dëmit material që i është shkaktuar paditësve në pronat e tyre me rastin e instalimit të linjës 110KV. Në këtë rast, ekspertizën e punuar nga eksperti A.Ç., të cilës gjykata e shkallës së parë i'a ka falur në tërësi besimin edhe gjykata e shkallës së dytë e vlerëson si profesionale, të qartë dhe të mbështetur në provat tjera në shkresat e lëndës e gjithashtu e njëjta është e punuar në përputhje të plotë me nenin 86 të LPDTS-së, kalimi i domosdoshmëm ku në par. 5 është e përcaktuar se: *“Ky nen zbatohet edhe për vendosjen e lidhjeve për furnizim”*, dhe ka vendosur që ky shpërblim të bëhet si tërësi.

Në këtë rast, Gjykata e Apelit e ka pranuar vlerësimin e ekspertit për vlerësimin e pronave sipas vlerës së tregut, duke pasur parasysh pozitën e pronave, potencialin e zonës dhe të pronave si dhe parametrat tjera krahasuese nga ku nxjerrë përfundim të drejtë dhe të pranueshëm për lartësinë e vlerës së pronave në të cilat është vendos e drejta e servitutit të kalimit. Gjykata ankimore i ka pranuar vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me raportin e vlerësimit për këto prona dhe për ekspertizën e nxjerrë si prova në procedurë gjyqësore sipas të cilave vlerësimet është pranuar si e besueshme për të përcaktuar lartësinë ekspertiza e ekspertit të licencuar të cilin e ka caktuar gjykata në raport me ekspertizat tjera të nxjerra në atë procedurë, duke qenë se ekspertiza vlerësuese e ekspertit A.Ç. ishte në përputhje të plotë edhe me Rregulloren mbi përcaktimin e zonës nën servitut për linjat transmetuese 110, 220 dhe 400 kV, numër 726 dt.03.11.2014, e nxjerr nga KOST.

Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së paditësve, i ka vërtetuar shumat e kompensimit të aprovuara në pjesën e dytë të dispozitivit të aktgjykimit të

atakuar, ndërsa ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e palës së paditur, sipas së cilës, gjykata nuk duhet t'ia falë besimin ekspertizës vlerësuese, duke qenë se e paditura KOST për pronën lëndore në të cilën është themeluar e drejta e servitutit është e bazuar sipas lejes ndërtimore, vendimit përfundimtar dhe akteve tjera administrative. Në anën tjetër është refuzuar edhe ankesa e palës paditëse me të cilën është atakuar pika III e dispozitivit të atakuar, ku e njëjta ka pretenduar se gjykata me rastin e vendosjes është dashtë që të marrë për bazë variantin e parë të ekspertizës së ekspertit A.Ç., apo mendimin e Grupit të ekspertëve lidhur me shumat e gjykuara, ashtu që të aprovohet edhe pika III e dispozitivit e cila është refuzuar, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit ekspertizës të cilës gjykata e shkallës së parë i'a ka falur në tërësi besimin është në përputhje me nenin 86 të LPDTS-së. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Pika IV dhe V, e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar nuk janë shqyrtuar nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi qe këto pjesë të dispozitivit të aktgjykimit nuk janë atakuar përmes ankesave të ushtruara nga palët ndërgjyqës.

Më tutje, gjykata e shkallës së dytë e ka vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa ka vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale konform nenit 452 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7095/2021, më datë 18.10.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.